

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë në zbatim të ligjit Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Urdhërit Nr.344, datë 19.08.2013 "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social", shpall konkurimin për **1(një)** vend të lirë në pozicionin Psikolog, në Njësinë e Shërbimit Psiko-Social të shkollave në varësi të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë.

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT.

Psikologu: Të ketë mbaruar arsimin e lartë, në fushën e Psikologjisë (Diplomë universitare "Bachelori" në degën e Psikologjisë, si dhe studime Master Shkencor në Psikologjinë Shkollore ose "Psikologji Klinike" ose Master Profesional "Keshillim psikologjik" ose në drejtimet e tjera të përafërta).

- Të ketë njohuri të mira të një gjuhe të huaj, me përparësi gjuhën angleze.
- Të zotërojë njohjen e programeve bazë kompjuterike.
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese dhe të punës në grup.

Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda orës 16.30 të datës 19.06.2017, në Sekretarinë e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, me adresë: Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë, këto dokumenta: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, të çertifikateve të kualifikimit, dëshmime të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti të lëshuar Brenda 3 muajve) si dhe të paktën 1(një) letër rekomandimi, një numër telefoni për tu kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell s'kualifikim të kandidatit).

Pas verifikimit paraprak, me datë **21.06.2017**, në ambientet e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë si dhe në dartiraneqark.arsimi.gov.al, do të shpallet lista e konkurrentëve, që do të

vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë.

Konkurimi do të bazohet në njohuri mbi Ligjin Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Urdhërit.Nr.344, datë 19.08.2013 "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social", Manuali i psikologut, Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar, si dhe njohuri specifike për pozicionin e vendit të punës

DREJTOR

Eglantina METANI

